

## Ligj i ri për “Për Standardizimin”

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) tashmë do të punojë sipas Ligjit Nr. **9870**, datë **04.02.2008** “Për Standardizimin”, i cili është dekretuar nga Presidenti i Republikës me numër dekreti 5625, datë 18.02.2008 dhe botuar në fletoren zyrtare nr.18, datë 19.02.2008.



Brenda këtij viti ky ligj do të ketë edhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, duke krijuar kështu paketën e re ligjore të DPS. Por le të ndalemi pak tek Ligji i ri. Çfarë të re sjell ai për Standardizimin në Shqipëri, çfarë ka ndryshuar nga ligji i vjetër, kush janë dokumentet bazë në të cilat ai është mbështetur, etj.? Këto janë disa nga pyetjet, të cilat marrin përgjigje në vijim:

Në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit theksohet se standardizimi është një ndër elementet kyç të tregtisë së lirë për mallrat dhe shërbimet. Në këtë marrëveshje, në nenin 75, pika 1, thuhet: “Shqipëria merr masat e nevojshme për të siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregulloret teknike të Komunitetit dhe procedurave europiane të standardizimit. Gjithashtu, ndër të tjera në këtë nen në pikën 2 të tij thuhet: Për këtë qëllim palët do të fillojnë në një fazë të hershme: - nxitjen e përdorimit të rregulloreve teknike të Komunitetit, standardeve europiane dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit, - nxitjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në veprimtarinë e organizatave që kanë të bëjnë me standardet si CEN, CENELEC, ETSI etj”.

Nisur nga kjo dhe detyrat e parashikuara në Marrëveshje iu bë një rishikim i plotë i ligjit të vjetër, i cili çoi në konkluzionin se ky ligj ishte i papërshtatshëm për të realizuar qëllimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve, ishte i papërshtatshëm për t’ju përgjigjur kërkesave të kohës. Pra duhej një ligj që të përfronte në mënyrë të plotë rekomandimet e BE-së në zbatim të legjislacionit, standardeve dhe praktikave europiane e ndërkombëtare në fuqi për fushën e standardizimit.

Arsye tjetër për rishikimin ishte edhe zbatimi i rekomandimeve të BE-së lidhur me funksionimin e infrastrukturës së cilësisë në vend (ndarja e funksioneve të akreditimit dhe certifikimit nga ato të standardizimit) dhe ndryshimi varësisë nga Këshilli i Ministrave në atë të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.



Ligji i ri i Standardizimit për të plotësuar boshllëkun e evidentuar më lart, për të qënë në përputhje me parimet dhe për të përmbushur qëllimin e aktivitetit

të standardizimit, është mbështetur në përcaktimet e dhëna në dokumente europiane e ndërkombëtare si vijon:

Rekomandimet e dhëna në botimin e KE-së, rishikuar në 2005 “Strukturat kryesore administrative të nevojshme për implementimin e *acquis* – pika 1 – **Lëvizja e Lirë e mallrave - Masat Horizontale**, gërma a) **Standardizimi**;

Direktivën 98/34/EC datë 22.06.1998 „**Shkëmbimi i informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike**“ botuar në OJ L 204/37 datë 21.07.1998;

Ligjin nr. 8648, datë 28.7.2000 për ratifikimin e “Protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë” - **Marrëveshja e Barrierave Teknike në Tregti** Aneksi III “**Kodi i praktikës së mirë për përgatitjen, adoptimin dhe zbatimin e standardeve**”;

Rregulloren e brendshme nr. 2 të Komiteve Europiane të Standardizimit CEN & CENELEC „**Rregulla të përbashkëta për punën e standardizimit**“;

Rregulloren e brendshme nr. 3 të Komiteve Europiane të Standardizimit CEN & CENELEC „**Rregulla për strukturën dhe draftimin e publikimeve/ standardeve të CEN&CENELEC**“;

Udhëzuesi 10 i CEN & CENELEC „**Udhëzime për shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve/ standardeve të CEN&CENELEC**“;

Standardin Shqiptar që ka adoptuar atë ndërkombëtar **S SH ISO 17011**;

Standardin Shqiptar që ka adoptuar atë ndërkombëtar **S SH EN 45020** „**Standardizimi dhe aktivitetet që lidhen me të – Fjalor i Përgjithshëm**.”

Ligji i ri „Për Standardizimin“ përbëhet nga 26 nene të ndara në 5 krerë sipas strukturës së mëposhtme:

Kreu I - Dispozita të Përgjithshme - në nenin 1 të tij përcaktohet objekti dhe qëllimi i ligjit, si me poshtë:

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për:
  - a) zhvillimin e gjithë aktivitetit të standardizimit në nivel kombëtar;
  - b) organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, si Organi Kombëtar i Standardizimit në Shqipëri; si dhe
2. Qëllimi i këtij ligji është:
  - a) që të përmirësojë kuadrin ligjor ekzistues në fushën e standardizimit duke përfshirë përgatitjen dhe publikimin e Standardeve Shqiptare dhe zbatimin e tyre.

Ndërsa Ligji i vjetër në nenin 1 të tij paraqet dispozita të cilat rregullojnë funksionet si standardizimi dhe certifikimi duke i administruar ato në një drejtori të vetme, duke financuar nga buxheti i shtetit një aktivitet privat (çertifikimin) dhe duke i krijuar kështu atij një pozicion me të privilegjuar në raport me organizmat e tjerë në treg dhe që ishte në kundërshtim të plotë me rekomandimet që jepen në dokumentin „Strukturat kryesore administrative të nevojshme për implementimin e *acquis* – pika 1 – Lëvizja e Lirë e mallrave - Masat Horizontale“.

Në Ligjin e ri Neni 3 - Përkufizime, Neni 4 - Parimet e aktivitetit kombëtar të standardizimit, Neni 5 - Qëllimi i aktivitetit të standardizimit, janë dhënë të plota dhe në përputhshmëri me përcaktimet e dhëna në përkufizimet e dhëna në S SH EN 45020 veçanërisht pika 1 – Standardizimi, pika 2 – Qëllime të Standardizimit, pikën 3.2.1 – Standarde në pozicion të publikut, pikën 9.1 – Programi i standardizimit, Direktivën 98/34/EC pika 6, 7, 9, 10 e saj, Rregulloren e brendshme nr. 2 të CEN&CENELEC – pika 2 Përcaktime, pika 2.9 – Dokument Harmonizimi, Rregulloren e brendshme nr. 3 të CEN&CENELEC pika 3 – Terma dhe përcaktime.

Rëndësi të veçantë kanë dispozitat e Nenit 7 të projekt ligjit – Zbatimi i Standardeve Shqiptare, pikat 3, 4, 5, dhe 6 të tij që rregullojnë mënyrën e referimit të standardeve në rregullat teknike. Këto dispozita janë në përputhje me standardin S SH EN 45020 pika 11 – Referenca ndaj standardeve në rregulla teknike – nënpika 11.1 – referencë ndaj standardeve, nënpika 11.3.2 – referencë treguese.

Kreu II, neni 8 – Organi Kombëtar i Standardizimit, Neni 9 – Përfaqësimi, Neni 14 – Kompetencat, janë në mbështetje të nenit 4 – Përgatitja, adoptimi dhe aplikimi i standardeve i Marrëveshjes mbi Barrierat Teknike në Tregti dhe Aneksi 3 - Kodi i Praktikës së Mirë për Përgatitjen, Adoptimin, dhe Zbatimin e Standardeve si dhe me Rregulloren e brendshme nr. 2 të CEN&CENELEC paragrafi 11 – Publikimet e CEN&CENELEC.

Në Ligjin e ri neni 10 – Organet Drejtuese, Neni 11 – Bordi teknik, Neni 12 - Komitetet Teknike dhe Neni 13 – Anëtarësimi, janë dispozita që parashikojnë rregullime të domosdoshme për një organizëm standardizimi bashkohor, të cilat janë në përputhje të plotë me Rregulloren e brendshme nr.2 të CEN&CENELEC paragrafi 3 – Struktura organizative dhe përgjegjësitë për punën e standardizimit veçanërisht paragrafët 3.1 – Bordi Teknik, 3.1.1 – Funkzioni, 3.2 – Komitetet Teknike, 3.2.2 – Anëtarësimi.

Nenet 15, 16 dhe 17 të Ligjit të ri parashikojnë dispozita në lidhje me hartimin, adoptimin dhe miratimin e një Standardi Shqiptar, kush e bën propozimin dhe kush janë arsyet e këtij propozimi, publikimin e standardeve shqiptare, hartimin, adoptimin dhe miratimin e dokumenteve shqiptare të standardizimit, konfirmimin, amendimin, ripunimin dhe shfuqizimin e Standardeve Shqiptare apo dokumenteve shqiptare të standardizimit, të cilat janë në përputhje të plotë me

nenin 4 – Përgatitja, adoptimi dhe aplikimi i standardeve i Marrëveshjes mbi Barrierat Teknike në Tregti dhe Aneksi 3 - Kodi i Praktikës së Mirë për Përgatitjen, Adoptimin, dhe Zbatimin e Standardeve, si dhe me Rregulloren e brendshme nr. 2 të CEN&CENELEC paragrafi 11 – Publikimet e CEN/CENELEC me Rregulloren e brendshme nr. 2 të CEN&CENELEC paragrafi 11 – Publikimet e CEN/CENELEC në ndryshim nga ligji i vjetër që nuk i parashikonte ato.

Neni 18 i projekt ligjit – E drejta e autorit, e shitjes dhe pronësia intelektuale rregullon çështjet që lidhen me të drejtën e autorit për formën dhe përmbajtjen e çdo Standardi Shqiptar apo dokumenti standardizimi, rregullon çështjet që lidhen me të drejtën ekskluzive dhe pronësinë intelektuale për publikimin, riprodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e projekt standardeve dhe Standardeve Shqiptare, projekt dokumenteve dhe dokumenteve shqiptare të standardizimit, si dhe të drejtën e DPS-s për të caktuar agjentë apo shpërndarës me qëllim shitjen ose shpërndarjen e Standardeve Shqiptare dhe dokumenteve shqiptare të standardizimit. Ky nen është mbështetur në ligjin nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”; pikën 9 - E drejta e autorit – në Rregulloren e brendshme nr.2 të CEN&CENELEC dhe Udhëzuesin 10 i CEN & CENELEC „Udhëzime për shpërndarjen dhe shitjen e publikimeve/standardeve të CEN&CENELEC“.

Ligji i ri implementohet menjëherë, nuk kërkon struktura të specializuara apo shtesë për zbatimin e tij, është i një niveli që i përgjigjet nevojave të kohës dhe në perspektive dhe është, siç edhe është detajuar më lart, në përputhje me ligje, direktiva dhe standarde e rregullore europiane e ndërkombetare në fuqi për aktivitetin e standardizimit dhe fushave që lidhen me të.

Miratimi dhe zbatimi i Ligjit të ri „Për Standardizimin“ krijon hapësirat e nevojshme ligjore për ngritjen dhe funksionimin efektiv të sistemit kombëtar të standardizimit në përputhje me praktikatat europiane në këtë fushë dhe arrihet progresi i kërkuar i përafërimit të legjisllacionit tonë me atë të BE-se si dhe krijohet mjedisi i përshtatshëm për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të MSA.

Gjithashtu, përgatitja dhe miratimi i akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij krijojnë një kuadër ligjor të përshtatshëm dhe sipas kërkesave të BE-së dhe prioriteteve të Qeverisë sonë për një **sistem modern, në përputhje me praktikatat ekzistuese europiane e ndërkombëtare në fushën e standardizimit, e cila do t'i përgjigjej më mirë nevojave të vendit për produkte e shërbime më të garantuara e cilësore për konsumatorin vendas, për konkurrence të lirë brenda vendit dhe rritjen e imazhit të produkteve e shërbimeve “Made in Albania” të destinuara për tregjet rajonale e më gjerë.**

Disa nga aktet nënligjore që do t'i propozohen Këshillit të Ministrave në zbatim të Ligjit të ri „Për Standardizimin“, nr. 9870, datë 04.02.2008 do të jenë për adoptimin e Direktivave përkatësisht

1. Direktiva 98/34/EC, datë 22 Qershor 1998 “Shkëmbimi i informacionit në fushën e standardeve teknike dhe rregulloreve” publikuar në OJ L 204/37, datë 21.7.98 e cila rregullon aktivitetet dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit në fushën e Standardeve dhe Rregullave Teknike; dhe
2. Direktivën 98/48/EC, datë 20 Korrik 1998, “Shkëmbimi i informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike si dhe rregullat e shërbimeve për informimin e shoqërisë” amendim i Direktivës 98/34/EC, datë 22 Qershor 1998. OJ L 217/18, date 5.8.98; gjithashtu,
3. Projekt VKM për funksionimin dhe përbërjen e Bordit Drejtues të DPS;
4. Projekt VKM për adoptimin e Marrëveshjes së OBT-s mbi „Barrierat Teknike në Tregti“ në zbatim të ligjit nr. 8648, datë 28.7.2000 “Për ratifikimin e Protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë”.